

VENDIM
Nr. 69, datë 11.5.2015

**MBI MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS SË
ERE-s, PARASHIKUAR NË NENIN 4 TË LIGJIT NR. 119/2014, “PËR TË DREJTËN E
INFORMIMIT”**

Në mbështetje të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 4, të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.5.2015, pasi shqyrtoi kërkesën e Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe dëgjoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

- Enti Rregullator i Energjisë është autoritet publik në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe nenit 2, pika 1, të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”.

- Në zbatim të nenit 4, të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin dhe zbatimin e programeve të transparencës së ERE-s, parashikuar në nenin 4, të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për implementimin e programit të transparencës sipas këtij vendimi e lidhjeve bashkëngjitur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti